




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 12 Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR BURSAT E  
STUDENTEVE

**Neni 1**  
**Përbërja**

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2021/2022, Nr.4-670-3101 datë 17.01.2022, në këtë përbërje:

1. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, kryesuese
2. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Albulena Govori, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësit**

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2021/2022, Nr.4-670-3101 datë 17.01.2022. Komisioni do të shqyrtoj ankesat në bazë Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 si dhe Rregullorës për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullorës 15Nr.670-19941 të datës 29.05.2020 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-47372 të datës 30.09.2020 si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse në fuqi.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 1-020-3757  
Lipjan, më 19.01.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

